

RAIFFEISEN BANK INTERNATIONAL GROUP

KODI I SJELLJES për FURNITORËT

(në vijim referuar si "KS")

HYRJE

Bazuar në vlerat thelbësore të RBI që trajtojnë etikën e biznesit, angazhimet shoqërore dhe mjedisore, RBI kërkon që Furnitorët e saj t'i përmbahen Parimeve të renditura në vijim (siç përcaktohet më poshtë), të cilat do të zbatohen për çdo kontratë të lidhur ndërmjet tyre ("Kontrata"). KS zbatohet për të gjithë Furnitorët e RBI që dorëzojnë mallra, shërbime ose licenca për ose në emër të ndonjë prej njësive të biznesit dhe filialeve të RBI. Furnitori bën çmos për të zbatuar këto Parime në të gjithë zinxhirin e furnizimit. Ky KS nuk ka për qëllim të zëvendësojë legjislacionin dhe rregulloret në fuqi në çdo vend ku operon RBI. Ai kërkon të inkurajojë dhe respektojë këtë legjislacion dhe rregullore dhe siguron që këto të fundit të zbatohen me besnikëri dhe në mënyrë efektive. Furnitori bashkëvepron me ndershmëri, transparencë dhe vlerësim të ndërsjellë me Grupin e RBI dhe përfaqësuesit e tij.

PARIMET

1. Sanksionet dhe embargot ekonomike:

Përveç dispozitave të mëposhtme siç janë detajuar në seksionet 1 deri në 7 më poshtë, Furnitori kontrollon sanksionet dhe embargon e mundshme ekonomike [veçanërisht, por pa u kufizuar në legjislacionin dhe rregulloret e Bashkimit Evropian dhe çdo Autoriteti Evropian (p.sh. Autoriteti Bankar Evropian, Banka Qendrore Evropiane, Bordi me Rezolucion të Vetëm)] dhe shmang çdo veprim lidhur me marrëdhëniet e biznesit me Grupin e RBI, çka në fund mund të rezultojë në shkelje të sanksioneve ose embargove nga Grupi i RBI.

2. Parimet themelore

Furnitori respekton objektivat ndërkombëtare klimatike siç u përcaktuan në Konferencën e KB për Ndryshimet Klimatike në Paris (COP21), të drejtat e njeriut të shpallura ndërkombëtarisht dhe shmang bashkëpunimin në rastet e abuzimeve të çdo lloji të të drejtave të njeriut. Furnitori respekton dinjitetin personal, privatësinë dhe të drejtat e secilit individ. Ndalohet puna e detyruar në të gjitha format. Për më tepër, Furnitori i përmbahet të gjitha standardeve të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO).

3. Praktikrat e përgjegjësisë sociale

3.1 Liria e organizimit dhe e drejta për negociata kolektive

Furnitori kërkon të zbatojë standardet e njohura ndërkombëtarisht pa shkelur legjislacionin kombëtar. Ai garanton se punonjësit dhe përfaqësuesit e tij, përfshirë punonjësit e përkohshëm (të agjencisë) mund të shprehen hapur në shoqërinë e tyre lidhur me çështjet për kushtet e punës.

3.2 Puna e fëmijëve

Puna e fëmijëve siç përcaktohet nga ILO-IPEC dhe neni 32 i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (UNCRC) është rreptësisht e ndaluar.

Nëse ndonjë fëmijë gjendet në ambientet e Furnitorit, Furnitori menjëherë merr masa për të korrigjuar situatën në përputhje me interesat më të mira të fëmijës.

3.3 Diversiteti dhe mosdiskriminimi

Furnitori ndalon dhe lufton format negative të diskriminimit bazuar në moshën, përkatësinë etnike, racën ose ngjyrën, origjinën kombëtare, fenë ose besimin, mendimin politik apo tjetër, gjininë, orientimin seksual ose paaftësinë e një personi, dhe promovon diversitetin, mundësinë ose trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion. Furnitori trajton të gjithë punonjësit me respekt dhe nuk përdor ndëshkimin trupor, dhunën psikologjike ose fizike, asnjë formë abuzimi ose ngacmimi apo kërcënime të tilla.

3.4 Paga

Furnitori siguron shpërblimin sipas standardit ligjor kombëtar për pagën minimale dhe shmang çdo zbritje të pagës si masë disiplinore. Kur nuk ekzistojnë standarde ligjore kombëtare, shpërblimi është i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat themelore (ILO C131 - Konventa për Rregullimin e Pagës Minimale).

3.5 Orët e punës

Orët e punës, përfshirë kohën shtesë, janë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm vendas. Kur nuk ekzistojnë standarde ligjore kombëtare, zbatohen standardet e ILO-s.

3.6 Shëndeti dhe siguria në punë

Furnitori u siguron punonjësve të tij një vend pune të sigurt dhe të shëndetshëm dhe duhet të zbatojë programe efektive - kur është e nevojshme - për të përmirësuar mjedisin e punës. Furnitori bën çmos për të kontrolluar rreziqet dhe për të marrë masat e nevojshme parandaluese kundër aksidenteve dhe sëmundjeve në punë. Furnitori inkurajohet të zbatojë një Sistem të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë bazuar në standarde ndërkombëtare si OHSAS 18001 ose të ngjashme.

4. Praktikat e përgjegjësive mjedisore

4.1 Mbrojtjen e mjedisit

Furnitori vepron në përputhje me standardet përkatëse të njohura mjedisore vendase dhe ndërkombëtare dhe legjislacionin e zbatueshëm vendas, ku standardi më i lartë zbatohet veçanërisht duke përfshirë ROHS (Kufizimi i Substancave të Rrezikshme) dhe WEEE (Mbetjet nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike). Furnitori minimizon ndikimin e tij në mjedis dhe duhet të zbatojë masa që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit.

RBI pret që Furnitori të ndjekë rregullat e ekonomisë qarkore gjatë gjithë ciklit jetësor të produktit: konceptimi, zhvillimi, prodhimi, transportimi, përdorimi dhe asgjësimi dhe/ose riciklimi. Furnitori minimizon ose përpiqet të shmangë emetimet e rrezikshme të ajrit, konsumin e energjisë dhe emetimet e CO₂. Në veçanti, Furnitori zhvillon produkte dhe shërbime që kanë konsum të ulët të energjisë dhe ulje të emetimit të CO₂ gjatë gjithë ciklit jetësor.

4.2 Menaxhimi i mbetjeve dhe i burimeve

Furnitori kufizon përdorimin e materialeve dhe burimeve kur merr ose prodhon mallra në mënyrë që të minimizojë ndikimin e tyre në mjedis.

Furnitori inkurajohet të gjertojë burimin e mineraleve të konfliktit, të promovojë transparencën përgjatë zinxhirit të tij të furnizimit dhe të vendosë masa për këtë qëllim. Përdorimi i burimeve të rralla kufizohet ose shmangët kur është e mundur. Mbetjet e prodhuara nga të gjitha aktivitetet e tyre identifikohen, monitorohen dhe menaxhohen. Furnitori përpiqet të zvogëlojë prodhimin e mbetjeve. Trajtimi i mbetjeve bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi të mjedisit.

5. Integriteti i biznesit

5.1 Parimet kundër korrupsionit dhe krimit financiar

Furnitori shmanget nga çdo formë e veprimeve të lidhura me korrupsionin ose krimin financiar që mund të interpretohen si të tilla. Furnitori është i vetëdijshëm për çdo legjislacion të zbatueshëm (veçanërisht, por pa u kufizuar në Aktin e Praktikave të Korrupsionit të Huaj të ShBA., Aktin e Ryshfetit të MB) dhe shmang çdo veprim në lidhje me marrëdhëniet e biznesit me Grupin e RBI, të cilat mund të rezultojnë në fund në shkelje të ligjit nga Grupi i RBI.

Çdo konflikt i mundshëm ose ekzistues interesi (p.sh. marrëdhënie e ngushtë, punë plotësuese) midis furnitorit/punonjësve të furnitorit dhe RBI-së duhet t'i bëhet me dije menjëherë RBI-së përmes kanaleve të përcaktuara të komunikimit.

Furnitori nuk mund t'u ofrojë, pretojë ose japë përfitime të paligjshme zyrtarëve publikë ose vendimmarrësve kombëtarë ose ndërkombëtarë që veprojnë në sektorin privat, duke përfshirë por pa u kufizuar te përfaqësuesit e bankave për të përfutur trajtim preferencial ose vendim të favorshëm; e njëjta gjë vlen kur merren donacione, dhurata ose ftesa për dreka/darka dhe evente biznesi.

Furnitori nuk lejon që t'i pretohen ose ofrohen avantazhe dhe nuk e pranon këtë gjë nëse ky veprim mund ose e bën palën, e cila ofron avantazhet të mendojë se mund të ndikojë në këtë mënyrë në vendimet e biznesit. Po kështu, Furnitori nuk kërkon avantazhe.

Në mënyrë që të sigurojë përputhshmëri me Kodin për kohëzgjatjen e Kontratës, Furnitori i siguron RBI-së sipas kërkesës dhe në çdo kohë të gjithë elementët e kërkuar për të vendosur këtë përputhshmëri dhe informon RBI-në, pa vonesë, kur ka dijeni ose ka arsye të mendojë se ka mospërputhshmëri me Rregullat nga vetë ai ose ndonjë Palë e Tretë, si dhe me masat korrigjuese të miratuara për të siguruar përputhshmërinë me Rregullat. Mospërputhshmëria materiale me Rregullat mund të sjellë si pasojë të drejtën e zgjidhjes së Kontratës në përputhje me dispozitat e saj.

5.2 Parimi i konkurrencës së lirë

Furnitori respekton rregullat e konkurrencës së lirë dhe të ndershme në të gjitha marrëdhëniet e biznesit, dhe në veçanti nuk vepron kundër konkurrencës dhe/ose ligjit antitrust. Furnitori nuk bashkëpunon në mënyrë të fshehtë, nuk shkëmben apo zbulon informacione me ndonjë palë të tretë lidhur me ndonjë prokurim të planifikuar, në zhvillim ose në pritje të Grupit të RBI.

5.3 Parimi i sponsorizimit

Të gjitha masat e sponsorizimit nga Furnitori duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi vendas (kombëtar).

5.4 Parimi i kontributeve politike

Furnitori dhuron para ose jep ndonjë përfitim monetar për ndonjë parti politike brenda rregullores nga ligji vendas (kombëtar) dhe në përputhje me ligjin vendas (kombëtar).

5.5 Parimi kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit

Raiffeisen Bank International është e angazhuar që të veprojë plotësisht në përputhje me të gjitha direktivat e zbatueshme të BE-së dhe legjislacionin vendas (kombëtar). Ne refuzojmë të bërit biznes në një mënyrë që ndihmon ose lehtëson evazionin fiskal nga Furnitorët tanë ose palët e tjera të treta. Ne i konsiderojmë Furnitorët tanë si një shtyllë të rëndësishme në parandalimin e pastrimit të parave dhe në përpjekjet kundër financimit të terrorizmit dhe presim që si i tillë Furnitori të marrë të gjitha masat për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit brenda sferës së tij të ndikimit. Për Furnitorët, të cilët janë ligjërisht të detyruar të zbatojnë këto politika dhe procedura, Furnitori i zbaton dhe u përmbahet plotësisht këtyre ligjeve të ndryshuara herë pas here.

5.6 Pronësia intelektuale, siguria e të dhënave dhe mbrojtja e të dhënave

Furnitori është në përputhje me Marrëveshjen e Mospublikimit (ose të ngjashme) të lidhur me Anëtarët e Grupit të RBI-së dhe i përmbahet të gjitha ligjeve të zbatueshme të pronësisë intelektuale dhe mbrojtjes së të dhënave dhe të gjitha kërkesave specifike për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave për të cilat bihet dakord në Kontratë.

6. Nënkontraktimi

Furnitori përpiqet me përpjekjet më të mira të angazhojë kontraktorët dhe/ose nënkontraktorët e tij (në vijim referuar si "Nënkontraktorët") me Parimet e këtij KS për aq sa janë të përfshirë në produktet përfundimtare të provigjimit të konsiderueshëm sipas Kontratës. Furnitori përpiqet me përpjekjet më të mira të shmangë përdorimin e paarsyeshëm të nënkontraktorëve ose ndonjë pale të tretë për shërbimet sipas Kontratës për të shmangur kërkesat e zbatueshme ligjore dhe ndonjë prej standardeve të përcaktuara në KS.

Furnitori siguron që furnitorët e tij të marrin përsipër të:

- Nxisin dhe sigurojnë përputhshmërinë me parimet e këtij KS nga furnitorët dhe nënkontraktorët e tyre
- Zbatojnë një sistem monitorimi që u mundëson atyre të parandalojnë dhe trajtojnë çdo rrezik që ka ndikim mjedisor dhe/ose social në të gjithë zinxhirin e furnizimit.

7. Përputhshmëria, monitorimi dhe auditimet

Rekomandohet që Furnitori të caktojë një person përgjegjës me kompetencat dhe burimet e nevojshme për të zbatuar dhe ndjekur dispozitat e këtij KS (përfshirë, p.sh. garantimin që punonjësit e tij kuptojnë dhe janë në përputhje me këto standarde dhe monitorimin rregullisht të operimit të tyre për të siguruar përputhshmërinë me Kodin.)

RBI (përkatësisht, Pala e drejtpërdrejtë kontraktore e Furnitorit) mund të auditojë përputhshmërinë e Furnitorit dhe në disa raste të nënkontraktorëve me KS dhe informacionin e dhënë nga Furnitori. Nëse Furnitori ose nënkontraktorët janë në shkelje të KS, RBI (përkatësisht, Pala e drejtpërdrejtë kontraktore e Furnitorit) do të nisë një dialog dhe ka të drejtë të kërkojë një plan zbatimi për përmirësime, i cili do të bëjë të mundur që Furnitori dhe/ose nënkontraktori të jenë përsëri në përputhshmëri të plotë me KS.

Mospërputhshmëria materiale me parimet e Kodit nga Furnitori mund të sjellë si pasojë të drejtën e zgjidhjes së Kontratës në përputhje me dispozitat e saj, të iniciuara nga Pala e drejtpërdrejtë kontraktore e Furnitorit.

Furnitori është përgjegjës i vetëm për çdo shpenzim të bërë për të qenë në përputhje me KS.

Furnitori duhet t'i raportojë në mënyrë proaktive Prokurimit të RBI (përkatësisht, Palës së drejtpërdrejtë kontraktore të Furnitorit) për çdo devijim nga Kodi.

Furnitori ka të drejtë të përdorë Linjën e Sinjalizimit nga Grupi i RBI rbi.whispli.com/whistleblowing ose të dërgojë email në adresën compliance-gwb@rbinternational.com.